

28.06.2022
Ora 10:33

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, për shtyrjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaç, znj. M. Koja,**
Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **OJQ** **KRIK**
- **Të tjerë:** **Z. Kristaq Kume**

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Fillojmë seancën publike të ditës së sotme, e cila ka në rend dite këto çështje:

Shqyrtimin e kërkesës së Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, për shtyrjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”;

Pika e dytë është një projektvendim që lidhet me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.06.2022*

Pika e tretë, plotësimi vakancës në Këshillin e Bashkisë Sarandë;

Pika e katërt, plotësimi vakancës në Këshillin e Bashkisë Selenicë;

Pika e pestë ka të bëjë me përfundimin e hetimit të thelluar për kandidatin për deputet të propozuar nga Partia Lëvizja e Re, Qarku Lezhë, për zgjedhjet e vitit 2021;

Pika e gjashtë ka të bëjë me shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, Përgjegjësit të Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, Drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, Drejtor i Zyrës Vendore e të tjerë;

Pika e shtatë, po shqyrtimi administrativ i denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj Drejtorit të Galerisë së Arteve Shkodër dhe të tjerëve;

Pika e tetë, ka të bëjë me shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj kandidates për kryetare të Bashkisë Lushnje, dhe Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe të tjerëve;

Pika e nëntë, po shqyrtimi administrativ i denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj kandidates për kryetare të Bashkisë Shkodër, Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe të tjerëve, këto për zgjedhjet e 6 Marsit 2022;

Pika e dhjetë, po shqyrtimi administrativ i denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj kandidates për kryetare të Bashkisë Shkodër, Qendrës Shëndetësore “Rrethina”, Ambulanca Dobraç dhe të tjerë;

Pika njëmbëdhjetë ka të bëjë me shqyrtimin administrativ po të denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj kandidates për kryetare të Bashkisë Durrës, Ministrin të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe të tjerë;

Po, këto janë çështjet në rendin e ditës. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, për shtyrjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për disa ndryshime dhe shtesa në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Atëherë,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.06.2022*

i japim fjalën zotit Kristaq Kume për të prezantuar argumentat në lidhje me kërkesën.
Po zoti Kume!

Z. K. Kume: Përshëndetje të gjithëve, faleminderit zoti Celibashi! Siç dihet ne një grupim organizatash të shoqërisë civile me mbështetjen e “Lëviz Albania” dhe Agjencisë për Kooperim dhe Zhvillim të Zvicrës, kemi ndërmarrë në kuadër të një projekti që ka rreth një vit e gjysëm që ka filluar tashmë nismën qytetare për të çuar në Kuvendin e Shqipërisë projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Ndryshime të cilat do të prekin vetëm dispozitat e Kodit Zgjedhor që lidhen me zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore. Kërkesës që ne ju parashtruar disa kohë më parë për të na miratuar nisjen e procesit të grumbullimit të firmave dhe për të na pajisur me formularin tip, ju ju përgjigjët në kohë dhe ju përgjigjët ashtu siç ne ju kishim kërkuar. Madje kujtoj dhe tërheqjen e vëmendjes për faktin se mos vallë duhej pak më shumë kohë se sa ne kishim parashikuar që ta realizonim këtë nismë. Aktualisht së bashku me partnerët, ne kemi arritur sot, të paktën nga evidencat e djeshme të grumbullojmë rreth 72% të të gjithë firmave mbështetëse. Që do të thotë një progres i një pune të tillë që premtion që ta plotësojmë sipas asaj që kërkon dhe vendimmarrja juaj e parë lidhur me këtë gjë. Ajo që mua më duhet të theksoj dhe që ka qenë dhe motivi më i fortë pse kërkojmë që ju të rishikoni edhe njëherë afatin e përfundimit të këtij procesi, ka të bëjë me atë situatë që ne u ndeshëm në procesin e grumbullimit të firmave të qytetarëve. Nuk ishte proces i vështirë. Qytetarët nuk ishin “dashamirës” ndaj kësaj gjëje. Situata në fakt është shumë më ndryshe nga ajo që ndoshta mund të perceptohet në fillim. Për sa kohë që bëhej fjalë për një nismë ligjore për ushtrimin e një të drejte kushtetuese për diçka që kishte dhe ka të bëjë direkt me mirëqeverisjen e qytetarëve, në nivelin vendor, megjithatë reagimi qytetar ishte larg pritshmërive tona. Një ndër arësyet që

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.06.2022*

sipas gjykimit tonë në analizën që ne i kemi bërë këtij procesi “pse ndodh kështu”? Përtej të tjerave është e lidhur me faktin se qytetarët nuk janë të mirinformuar për të drejtat e tyre. Nuk e kuptojnë se çdo të thotë të ushtrosh të drejtën kushtetuese për të qenë ligjvënës. Se çdo të thotë dhe çfarë fuqie ka një ligjvënës qytetar me një ligjvënës në Kuvendin e Shqipërisë. Ose një ligj propozues në Kuvendin e Shqipërisë, ose qeveria që është një nga subjektet që propozon ligji. Të përballur me këtë situatë ne kemi biseduar edhe me donatorët. Ju kemi kërkuar atyre që të mbështesin idenë që këtë punë të nisur të mos e përfundojmë sipas afatit të parashikuar në kontratën e lidhur me ta, por ta shtyjmë dhe disa muaj të tjerë. Duke i kushtuar vëmendje të shtuar kontaktit me qytetarët, informimit të qytetarëve, nxitjen e qytetarëve dhe ndërgjegjësimin e tyre për vlerat që ka pjesëmarrja në ligjbërje, siç është dhe objekti i kësaj pune. Kemi marrë mirëkuptimin e tyre. Ndërkohë jemi duke vepruar në funksion të zhvillimit të kësaj qasje të re tonën ndaj nismës qytetare ligjvënëse. Me kënaqësi mund t’u them se po, ka efekte, në qoftë se do të dijmë se si dhe të dijmë ti tregojmë qytetarëve se ç’jemi duke bërë. Më lejoni t’u sjell vetëm një shembull. Pas kontaktit të bërë me drejtues të dy organizatave të pakicave kombëtare romë dhe egjiptiane dhe takimit të një pjese të stafit të tyre, pasi ata u dakordësuan me faktin që “po ne do të bëhemi pjesë e kësaj inisiative për të grumbulluar firmat”, koordinatorët e tyre brenda tre ditëve, ishte befasuese për mua, kanë arritur të grumbullojnë 750 e ca firma nga shtetasit që i përkasin atij komuniteti. Pra, për ta përfunduar i nderuar zoti Celibashi, kërkesa jonë ka të bëjë jo thjesht dhe vetëm me mundësinë kohore për të realizuar procesin formal të grumbullimit të 20 mijë firmave, por përdorimin sa më efektiv në funksion të asaj ç’ka ne organizata të shoqërisë civile kemi për detyrë dhe duhet të realizojmë në përpjeket që duhet të bëjmë si shoqëri për zhvillimin e kulturës së pjesëmarrjes, për zhvillimin e kulturës për të qenë pjesë e proceseve demokratike. Besoj se do të kemi mirëkuptimin tuaj

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.06.2022*

për këtë gjë, për sa kohë që në vlerësimin tonë, kufizim ligjor për këtë gjë nuk ka. Ju faleminderit që më dëgjuat!

Z. I. Celibashi: Faleminderit zoti Kume! Vlerësojmë që argumentat e prezantuara nga ana juaj për të mbështetur kërkesën për zgjatjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për propozimet Për disa ndryshime dhe shtesa në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë qëndrojnë, ndaj pranohet kërkesa juaj. Bazuar në nenin 19, pika 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 53, pika 3 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, vendos: Të zgjas afatin për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” deri në datën 30 Tetor 2022.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga data e shpalljes së këtij vendimi.

Faleminderit!

Z. K. Kume: Ju faleminderit zoti Celibashi, ju uroj vazhdim dhe punë të mbarë, mbi të gjitha shëndet të gjithëve!

Vendimi nr. 175

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

28.06.2022
Ora 10:43

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Sonila Ristan Meço”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaç, znj. M. Koja, znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** **S’ka!**
- **Të tjerë:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës. Kemi shqyrtimin e kërkesë për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier.

Z. Y. Merkaç: Këshilli i Bashkisë Fier, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, nga këshilltari zonja Eleni Nesti Gjikonaj, propozuar nga Partia Socialiste. Në bazë të nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 21, zonja Sonila Ristan Meço. Kandidati për anëtar të këshillit bashkiak ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 31. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

gjqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka dërguar verifikimin e të dhënave për zonjën Sonila Meço ku konstatohet se nuk ka ndryshime në përbërsit e gjendjes civile. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezulton se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Fier, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë, bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” pika 2 dhe neni 164, pika 2 dhe 4, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe Kreut V të vendimit nr.17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë vendos:

1. Zonja Sonila Ristan Meço, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Fier, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Sonila Ristan Meço.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendim nr. 176

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

28.06.2022
Ora 10:45

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Sarandë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zoti Faslli Mezan Beduli”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, znj. P.Doçaj**
- **Parti Politike:** **S’ka!**
- **Të tjerë:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikan tjetër të rendit të ditës, plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Sarandë.

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Sarandë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, nga këshilltari zoti Alqi Harallam Bambi, propozuar nga Partia Socialiste. Kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste, të cilit i kalon mandati i këshilltarit është kandidati me numër rendor 25 zoti Faslli Mezan Beduli. Kandidati për anëtar të këshillit bashkiak ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 33. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*


Gjendjes Civile ka dërguar verifikimin e të dhënave ku konstatohet se nuk ka ndryshime në përbërsit e gjendjes civile. Gjithashtu rezulton se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Sarandë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” pika 2 dhe neni 164, pika 2 dhe 4, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe Kreut V të vendimit nr.17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë vendos:

1. Zoti Faslli Mezan Beduli, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Sarandë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Sarandë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Faslli Mezan Beduli.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendim nr. 177

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

28.06.2022
Ora 10:47

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Selenicë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonja Mimoza Bahri Jaupaj”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, znj. P.Doçaj**
- **Parti Politike:** **S’ka!**
- **Të tjerë:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Selenicë.

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Selenicë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, nga këshilltari zonja Arlinda Pasho Muçaj, propozuar nga Partia Socialiste. Kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste, për Këshillin e Bashkisë Selenicë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit është kandidati me numër rendor 20 zonja Mimoza Bahri Jaupaj, e cila ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 34. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë konstatohet se nuk ka ndryshime

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

në përbërsit e gjendjes civile. Gjithashtu rezulton se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Selenicë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” pika 2 dhe neni 164, pika 2 dhe 4, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe Kreut V të vendimit nr.17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë vendos:

1. Zonja Mimoza Bahri Jaupaj, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Selenicë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Selenicë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonja Mimoza Bahri Jaupaj.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendim nr. 178

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

28.06.2022
Ora 10:49

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për deklarimin të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar të procedurës administrative të shqyrtimit të rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zoti Ilmi Sali Kuka, kandidat për deputet i propozuar nga Partia Lëvizja e Re, Qarku Lezhë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, znj. P.Doçaj**
- **Parti Politike:** **S’ka!**
- **Të tjerë:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

Z. Y. Merkaj: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati për deputet”. Në zbatim të këtyre dispozitave, zoti Ilmi Sali Kuka, kandidat për deputet i listës shumemërore të propozuar nga Partia Lëvizja e Re, Qarku Lezhë, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit. Përpara miratimit të listave të kandidatëve për deputetë për subjektin zgjedhor Partia Lëvizja e Re, në bazë të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

kompetencave të veta, KQZ bëri verifikimin paraprak pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ka ndërmarë hapat e mëposhëm:

- Ka dërguar kërkesë Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, ku rezultoi se nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë në sistem, pra nuk është i dënuar.
- Gjithashtu edhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka dërguar formularin e verifikimit ku nuk rezultoi të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile. Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 154 datë 17.03.2021, vendosi “Miratimin e listave shumëmemërore të Partisë Lëvizja e Re për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet zotit Ilmi Sali Kuka. Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, ka deklaruar se në vitin 2013-2018 është dëbuar nga Shteti Grek për arsye të mungesës së dokumentacionit. Gjithashtu ka deklaruar se në periudhën 1998-2013, ka qëndruar në Paros, Greqi, për arsye emigracioni. Në këto kushte, bazuar në nenin 8, pika 1, të Ligjit nr. 138/2015 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, për të kryer verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra, nga subjekti vetëdeklarues. Me shkresën nr. 538/53 prot., datë 17.06.2022, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin vetëdeklarues”. Në vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme, është konstatuar se janë bërë hetime të plota. Në fund është konstatuar se:
Nuk rezultoi të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, të padëklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

Nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj.


Nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj.

Nuk rezulton të ketë qenë i ndaluar, apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e ndonjë vepre penale.

Nuk rezulton të ketë qenë i siguruar me masë shtrënguese të sigurisë personale.

Rezultoi që ky shtetas është deportuar sipas vendimit nr. 63144/2, të datës 02.06.2013 i Drejtorisë së Policisë së Cyklades, Greqi. Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, konstaton se: Ligji nr. 138/2015 përcakton në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjeneralitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalimi arrestime, hetime, etj. Zoti Ilmi Kuka, kandidat i listës shumemërore të Partisë Lëvizja e Re në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, Qarku Lezhë, nuk ka marrë mandatin e deputetit. Subjekti zgjedhor Partia Lëvizja e Re referuar neneve 162 dhe 163 të Kodit Zgjedhor nuk ka fituar asnjë mandat në Qarkun Lezhë. Në kushtet kur subjekti vetëdeklarues, kandidat i listës shumemërore të Partisë Lëvizja e Re, nuk do të mund të përfitojë mandat në Qarkun Lezhë për këtë legjislaturë, Komisioneri nuk mund të shprehet me vendimmarrje për çështjen objekt shqyrtimi, për sa kohë ky subjekt nuk gëzon statusin e deputetit dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të neneve 10 dhe 11 të ligjit 138/2015, si dhe neneve 90 dhe 95 të ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” vlerësohet se ka

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin dhe vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” pika 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 90, 95 të Kodit të Procedurave Administrative, Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe pika 12, 13 e Kreut V të Vendimit nr.17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë vendos:


Të deklaroj të përfunduar procedurën administrative pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues zotin Ilmi Sali Kuka.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendim nr. 179

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

28.06.2022
Ora 10:55

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare”, ndaj z. Edison Memolla Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, z. Denis Dedej Përgjegjësit të Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, zj. Ana Dhamo Drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, z. Luan Shehi Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, zj. Margarita Dedej Drejtorit të Shkollës “Haxhi Qehaj” dhe zj. Mimoza Bidaj Drejtorit të Kopështit Rrogozhinë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2. Stafi KQZ:

Z. Ylli Merkaj, znj. Madalena Koja

Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj

• **Parti Politike:**

• **Të tjerë:**

- **KRIK, Ambasada Britanike**

- **Shkolla “Haxhi Qehajaj”:**

Z. Eduart Dedej

- **Qëndresa Qytetare:**

Z. Migen Qiraxhi, Znj. Teisa Kurti

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me shqyrtimin administrative të denoncimeve të organizatës Qëndresa Qytetare. Në rradhë të parë kemi shqyrtimin administrativ për denoncimin ndaj kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, ndaj zotit Edison Memolla Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, zotit Denis Dedej Përgjegjësit të Qendrës

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

Kulturore “Haxhi Memolla”, zonja Ana Dhamo, Drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, zoti Luan Shehi, Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, zonja Margarita Dedej, Drejtorit të Shkollës “Haxhi Qehaj” dhe zonja Mimoza Bidaj, Drejtorit të Kopështit Rrogozhinë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Nëse nuk gabojmë, e kemi shtyrë seancën e shkuar për të kërkuar informacion shtesë nga Bashkia Rrogozhinë, në lidhje me kontratat që janë lidhur me subjektet e tjera zgjedhore, për vënien në dispozicion të qendrës kulturore në fushatë zgjedhore. Është kërkuar informacion shtesë, gjithashtu nga Zyra Vendore Arsimore Durrës, në lidhje me pjesëmarrjen e nxënësve të Shkollës “Haxhi Qehaj” dhe fëmijët e kopështit Rrogozhinë për të marrë pjesë në inagurimin e qendrës kulturore.

Znj. T. Kurti: Për procedurë, i nderuar, nëse mundem në referim të nenit 58, 59 dhe 64 të Kodit të...

Z. I. Celibashi: Një sekondë të lutem, sa të verifikojmë prezencën e palëve! Nga Organizata Qëndresa Qytetare, janë përfaqësuesit! Nga subjektet e tjera të cilat janë të përfshira?

Z. E. Dedej: Vetëm përfaqësuesi i Drejtorit të Shkollës “Haxhi Qehaj”.

Z. I. Celibashi: Ju jeni përfaqësues i shkollës?

Z. E. Dedej: Po vetëm i shkollës, jo i subjekteve të tjera.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

Z. I. Celibashi: Përfaqësues nga Bashkia Rrogozhinë? Nuk ka prezent! Nga Drejtoria Rajonale Arsimore Durrës, Zyra Vendore Arsimore Rrogozhinë, nuk ka! Dakord! I muarët dokumentet e përfaqësimit të të gjithëve? Dakord, faleminderit! Emrin ju lutem?!

Z. E. Dedej: Eduart Dedej!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Fjala për përfaqësuesit e Organizatës Qëndresa Qytetare!

Znj. T. Kurti: Për procedurë, i nderuar, siç e thashë, në referim të nenit 58, 59 dhe 64 të Kodit të Procedurës Administrative, ne po depozitojmë sot përpara jush kërkesën për zgjerim të objektit të kërkesës dhe shtim të palëve pas njohjes me fakte dhe prova të reja të depozituara gjatë procesit. Në vijim të procesit administrativ të hetimit plotë e të gjithanshëm nga ana e juaj, jemi njohur me materiale plotësuese të cilat kërkuam në seancën dëgjimore të mëparshme dhe nisur nga fakti se hetimi vijon, në referim të këtyre materialeve të depozituara nga ana e Bashkisë Rrogozhinë, konstatohet se Qendra kulturore “Haxhi Memolla” si aset publik, objekt i denoncimit të sipërcituar. Aset ky në administrim nga organi i qeverisjes vendore Bashkia Rrogozhinë është përdorur masivisht në fushatë zgjedhore. Këto veprime të kryera nga subjektet zgjedhore janë provë për konstatimin e shkeljes së Kodit Zgjedhor, konkretisht nenit 91, pika 1 i cili parashikon që “me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji, mund të përdoren, ose vihen në mbështetje të kandidatit të partive politike, ose koalicioneve në zgjedhje, burime të organeve, apo enteve publike në nivel qendror, ose vendor”. Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj pranimin e provave dhe fakteve të reja të depozituara nga Bashkia Rrogozhinë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

Zgjerimin dhe plotësimin e objektit të denoncimit, duke pretenduar shkeljen e nenit 91 edhe për subjektet zgjedhore dhe kandidatët. Partia Socialiste dhe kandidati zoti Edison Memolla. Partia Demokratike, kandidati zoti Ferdinand Saraçi. Koalocioni zgjedhor “Shtëpia e Lirisë”, kandidati zoti Hekuran Xhani. Gjithashtu, kërkojmë konstatimin e shkeljeve nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe marrjen e sanksioneve administrative bazuar në nenin 171, 172 dhe nenin 10 të vendimit nr. 9 për subjektet e sipërcituara.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Pranohet kërkesa juaj si për zgjerimin e objektit si dhe për rrethin e subjekteve të cilët sipas pretendimeve tuaja duhet të procedohen nga pikëpamja administrative për shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor, në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Marsit 2022. I japim fjalën përfaqësuesit të drejtorit të Shkollës “Haxhi Qehaj”!

Z. E. Dedej: Siç e thashë edhe më parë, unë jam përfaqësues vetëm i drejtorit të Shkollës “Haxhi Qehaj”. Pra, jo i subjekteve të tjera të parashikuara në njoftimin për zhvillimin e seancës dëgjimore me dt. 20.06.2022. Në dispozicion kam dy akte, një i cili është njoftim për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe një akt tjetër që është kërkesë për informacion i datës 27.05.2022. Duke parë këto dy akte vëmë re se tek akti “kërkesë për informacion”, janë bërë dy pyetje nga ana juaj dhe në shkresën e datës 30.05.2022, me nr. prot. 596 është kthyer përgjigjja ku thuhet “në bazë të shkresës tuaj të datës 27.05.2022 me nr. prot. 2492 po ju përcjellim informacionin që na kërkonte duke ju përgjigjur pyetjeve. A ka qenë data 16.02.2022 ditë mësimi dhe deri në çfarë ore ka vijuar mësimi?”. Përgjigjja ka qenë “Data 16.02.2022 ka qenë ditë normale mësimi dhe mësimi ka vijuar deri në orën 13:50, kur mbaron ora e shtatë mësimore”. A keni pasur informacion në lidhje me pjesëmarrjen e nxënësve

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

në inagurimin e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” dhe nëse po, cili e ka dhënë lejen për pjesëmarrjen e nxënësve në këtë aktivitet? Në përgjigje thuhet “Nuk kemi informacion mbi pjesëmarrjen e nxënësve në inagurimin e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”. Pra, shihet që nga drejtori i Shkollës “Haxhi Qehaj” nuk ka pas asnjë vendim, qoftë ky në formë shkresore, detyrim, urdhër, apo shtysë të çfarëdolloji për pjesëmarrjen e nxënësve të Shkollës “Haxhi Qehaj” në këtë aktivitet. Qoftë ky vendim në formë të shkruar, qoftë dhe verbal. Në aktin e datës 27.05.2022, thuhet gjithashtu që “referuar nenit 91, pika 2 e Ligjit nr. 10019, dt.29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar parashikohet se “ndalohet përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore”. Pra, nuk kemi asnjë detyrim dhe nuk kemi shkelje të këtij neni për shkak se nga vetë akti juaj për njoftimin e zhvillimit të seancës dëgjimore thuhet që “Inagurimi i këtij objekti kulturor vjen vetëm tre ditë para çeljes së fushatës zgjedhore”. Pra, nuk jemi në kohën e specifikuar në nenin 91 pika 2, i cili specifikon kohën e fushatës zgjedhore. Gjithashtu nuk kemi takim për qëllime zgjedhore apo qëllime elektorale sepse nuk ka pasur asnjë lloj simboli, flamuri, shenje, emër kandidati apo çfarëdolloj tjetër të ndonjë subjekti elektoral, në takimin e datës 16.02.2022, por është thjesht një takim kulturor për inagurimin e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”.

Z. I. Celibashi: Po, dakord. Kishit ndonjë gjë për të shtuar?! Jo besoj!

Znj. T. Kurti: Për sa i përket informacioneve të ardhura, Drejtorja Rajonale pranon edhe njëherë me shkresën që ka sjellë pas kërimit të informacionit që pjesëmarrës në këtë aktivitet kanë qenë nxënësit e grupit artistik të Shkollës “Haxhi Qehaj” dhe te grupit artistik të kopështit Rrogozhinë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

Z. E. Dedej: E theksoj edhe njëherë që nga drejtori i Shkollës “Haxhi Qehaj” nuk ka pasur asnjë lloj vendimi qoftë në formë të shkruar qoftë në formë verbale.

Z. I. Celibashi: Dakord! Atëhere, do ta përfundojmë për sot shqyrtimin e kësaj çështje, do të njoftojmë të gjitha palët e interesuara për shtesën e objektit të kërkesës, do të caktojmë një afat për të dhënë pretendimet e tyre. Ndërkohë do t’ju njoftojmë për seancën tjetër për vazhdimin e shqyrtimit. Faleminderit për këtë pikë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.06.2022*

28.06.2022
Ora 11:05

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj zotit Fatmir Juka, Drejtor i Galerisë së Arteve Shkodër, zotit Xhemal Bushati, kandidati për kryetar i Bashkisë Shkodër dhe Partisë Demokratike, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z.Y.Merkaj, znj.M.Koja, znj. I.Osmanaj**
- **Parti Politike:** **PD (z. Marash Logu)**
- **Të tjerë:**
 1. Qëndresa Qytetare: **Z. Migel Qiraxhi, znj. Teisa Kurti**
 2. **KRIK**
 3. **Ambasada Britanike**

Z. I. Celibashi: Pikën 7 që ka të bëjë me shqyrtimin administrative për denoncimin ndaj zotit Fatmir Juka drejtor i Galerisë së Arteve Shkodër dhe të tjerë, me kërkesë të përfqësuesit të Partisë Demokratike do të duhet ta shtyjmë për një ditë tjetër pasi ai gjendet i angazhuar në një shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese dhe mesa duket nuk ka pasur mundësi për ta zëvendësuar. Kështu që, besoj edhe me mirëkuptimin e përfaqësuesit të Qëndresës, do e lëmë ndonjë ditë tjetër. Dakord! Faleminderit për mirëkuptimin.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.06.2022*

28.06.2022
Ora 11:06

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj zonjës Eriselda Sefa candidate për kryetare të Bashkisë Lushnje, zotit Haki Cako, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Ylli Merkaj, znj. Madalena Koja
Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj**
- **Të tjerë:**
 1. Qëndresa Qytetare: **Z. Migen Qiraxhi, znj. Teisa Kurti**
 2. Bashkia Lushnje: **Znj. Klodjana Hida**
 3. AKMC **Z. Jonian Harka**
 4. Vëzhgues: **KRIK, Ambasada Britanike**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tetë të rendit të ditës. Ka të bëjë me shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj zonjës Eriselda Sefa candidate për kryetare të Bashkisë Lushnje, Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, si dhe e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë së datës 6 Mars 2022. Atëherë, në seancën e shkuar ne vendosëm që t’i japim fund hetimit administrativ, por kemi marrë një kërkesë nga palët e interesuara në proces, të cilët kanë kërkuar që për shkak të marrjes me vonesë të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.06.2022*

njoftimit, e cila solli edhe mospjesmarrjen e përfaqësuesve të tyre në proces të rihapet procesi dhe t'ju jepet mundësia për të dëgjuar pretendimet e palëve. Atëherë përfaqësuesit e Qëndresës janë prezent, palët e tjera të interesuar nga përfaqësues të kandidatës për kryetare të Bashkisë Lushnje?

Znj. D. Hida: Diana Hida, përfaqësuese me prokurë nga kandidatja për kryetare bashkie dhe kryetarja aktuale e Bashkisë Lushnje, Eriselda Sefa.


Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Po nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

Z. I. Harka: Nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Jonian Harka, përfaqësues i institucionit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëhere në lidhje me këtë kërkesë të dy palëve, dy subjekteve të interesuara, përfaqësuesi i Qëndresës ka ndonjë mendim? Janë indiferent për këtë kërkesë, dakord. Mirë, atëherë unë vlerësoj se kërkesa duhet të pranohet, të shfuqizohet vendimi për përfundimin e hetimit administrativ, ta riçelimit hetimit administrativ dhe t'i japim fjalën përfaqësueses së kandidatës për kryetare të Bashkisë Lushnje në atë kohë edhe sot kryetare e Bashkisë Lushnje. Si dhe përfaqësuesit të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Atëhere, fjala është për ju zonjë!

Znj. D. Hida: Në kuadër të njoftimeve që na janë dërguar në lidhje me denoncimin e bërë nga Organizata Qëndresa Qytetare, ne jemi munduar për të raportuar edhe për të kthyer përgjigje në kohë dhe pyetjet kanë qenë konçize. Njëra nga pyetjet ka qenë, kush ka qenë organizatorja e takimit të kryer në Njësinë Administrative Dushk,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.06.2022*

Fshati Thanasaj, pranë Lumit Shkumbin. Ashtu siç dhe e kemi shkruar Kryetarja aktuale e Bashkisë edhe atëhere, kandidatja ka qenë në një vizitë inspektuese në njësinë administrative që ka qenë punë e saj për t'u kryer për funksionin që ajo mbante. Në këtë vizitë që ka qenë duke kryer aty, ka rastisur edhe Drejtori i AKMC zoti Haki Çako, i cili nga ana e tij mendoj, që ka qenë në rregull duke kryer një vizitë inspektuese në një investim që kryente institucioni që ai drejton. Dmth, ka pas rolin e tij mendojmë ne, kurse kryetarja e bashkisë ka qenë në një vizitë siç bën në çdo njësi në mënyrë periodike dhe aq më tepër njësia Thanasaj që është njësia kufizuese që na vendos edhe kufirin me Bashkinë e Rrogozhinës ka pasur edhe probleme nga Lumi Shkumbin gjatë stinës së dimrit, që janë edhe të njohura problemet, ka pasur edhe përmbytje. Herë pas here dhe aktualisht shkon dhe i viziton. Ajo ka ndjekur gjithmonë një praktikë pune për të qenë sa më afër qytetarëve dhe për të mbikqyrur çdo cep të njësisive territoriale që ka. Nuk ka pasur dmth një takim të organizuar nga ana e saj për këtë rast.


Z. I. Celibashi: Faleminderit! Keni më për të thënë?

Znj. D. Hida: Jo, këtë kisha për të thënë.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po, përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Z. J. Harka: Faleminderit zoti Komisioner në lidhje me denoncimin e Organizatës Qëndresa Qytetare mbi aktivitetin e pretenduar se është realizuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile për investimin në Lumin Shkumbin, pranë Fshatit Thanasaj. Dua të bëj sërish me dije ashtu sic ua kemi komunikuar në formë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.06.2022*

shkresore, që vizita e Drejtorit të Përgjithshëm nuk përbën aktivitet zyrtar të institucionit. Për këtë arsye nuk është raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve sipas formatit të përcaktuar në vendimin e Komisionit të Rregullator, për arsye se vizita ishte për çështje të përmbushjes së kontratës, pra është kryer në rolin e Autoritetit Kontraktor të investimit të realizuar. Një investim i cili ka nisur 7 muaj para se të niste procesi zgjedhor. Pra, kemi të bëjmë me një aktivitet rutinë të institucionit për përmbushjen e misionit të tij për parandalimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore. Në atë periudhë janë konstatuar disa elementë teknikë të investimit dhe ka pasur shqetësime të vazhdueshme si nga strukturat vendore dhe institucionet e tjera, mbi realizimin sa më të shpejt të këtij investimi. Për këtë arsye është bërë dhe vizita e Drejtorit të Përgjithshëm në rolin e Autoritetit Kontraktor. Ka qenë një vizitë e paplanifikuar me partnerët e tjerë vendorë, bashki ose prefecture dhe nuk ka pasur qëllim që të bëjë një komunikim publik për të promovuar këtë investim. Ka qenë thjesht për qëllime inspektimi mbi problematikën konkrete dhe ecurinë e investimit, por jo për çështje të fushatës zgjedhore. Madje institucioni jonë nuk ka vënë në asnjë moment në dispozicion të ndonjë subjekti zgjedhor burime të saja financiare apo logjistike. Pra, kjo ka qenë dhe arsyeja e vizitës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, përmbushja e detyrave funksionale të institucionit. Faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit. Përfaqësuesja e Qëndresës pyetje ose sqarim, replikë në lidhje me sa u tha?

Znj. T. Kurti: Faleminderit i nderuar! Përsa i përket fakteve që parashtruan palët në fakt kanë sjellë edhe përgjigje shkresore, ku deklarojnë tërësisht të kundërtën. Zotëria tha se investimi ka filluar 7 muaj më parë, mirëpo Agjencia pranon që fondet

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.06.2022*

janë alokuar në Dhjetor, dhe leja nga bashkia është miratuar në Janar. Është një përgjigje shkresore që ju vetë e keni sjellë. Gjë që e bënë këtë një investim me fonde të alokuara rishtazi. Promovimi i këtij investimi në kohën që përkon me fushatën zgjedhore, përbën një veprimtari të ndaluar në bazë të parashikimeve ligjore. E dyta, përsa i përket referimeve që ishte një takim rastësor, prania e shtuar e banorëve të cilët nuk ngurojnë të pozojnë me kandidatët, me drejtuesin politik të Qarkut Fier, zotin Taulant Balla, dhe drejtorin e AKMC-së, tregon që ky aktivitet nuk ishte rastësor. Kush i kishte lajmëruar këta banorë që të ndodheshin në ato momente pranë Lumit Shkumbin?

Z. I. Celibashi: Përfunduar? Po! Përfaqësuesi i Agjencise dhe pastaj përfaqësuesja me prokurë e kandidates.

Z. J. Harka: Faliminderit, sërish e përsëris. Pjesëmarrja në atë takim nuk ishte aktivitet i organizuar nga njësia. Për arsye teknike, nëse do të organizohej nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, kjo vizitë, do të merreshin të gjitha masat teknike, administrative për organizimin e një aktiviteti publik. Së pari, do të organizohej stafi i cili do të merrej me krijimin e infrastrukturës së nevojshme për një aktivitet publik, nëse do të kishim këtë qëllim. Së dyti, do të ishte raportuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për këtë aktivitet publik të planifikuar. Pra, nuk është aktivitet i organizuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Së dyti, lidhur me aspektin e çeljes së fondit në muajin Dhjetor. Atëherë kur bëhet fjalë për çështje të investimeve parandaluese, ka një proces planifikimi që shkon disa muaj para realizimit, dhe aspekti i buxhetimit është thjesht një cikël dhe nuk është se i paraprin procesit zgjedhor. Madje nuk mund të ndikohet nga një proces zgjedhor, sepse janë afatet ligjore, se kur duhet të mbyllet një procedurë administrative për

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.06.2022*

alokimin e një fondi, ose për mbylljen e ciklit të dokumentacionit në ndërtim dhe një veprë të kësaj natyre. Pra, e gjitha procedura administrative nuk është bërë për qëllime të fushatës zgjedhore pasi është e pamundur të parashikosh një proces administrative të kësaj natyre për qëllime fushate. Pra, pretendimi juaj nuk qëndron teknikisht në aspektin e procedurës administrative. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesia e kandidatës.

Znj. D. Hida: Unë do të thoja siç e citoi edhe zonja që ne kemi paraqitur deklaratën për kryerje punimesh dhe kërkesën e bërë nga AKMC, e shoh dhe datën aty që është e dhjetorit, por duke pasur pak përvojë në prokurimet publike disa vjeçare, di që të kryesh një prokurim dhe të arrish të mbyllësh një kontratë nevojitet që nga parashikimi i fondit, varet çfarë lloj kontrate do të qëllojë, sa është afati për paraqitjen e ofertave, ka/s'ka ankesa dhe mund të ketë zgjatur si procedurë edhe tre muaj. Duke nisur edhe komisionin e prokurimit që ka cikël më vete. Megjithatë kjo nuk është pjesë e bashkisë, është pjesë e AKMC-së. Fakti që kur Kryetaria e Bashkisë shkon gjithmonë në mënyrë, mund të themi të përditshme në njësitë administrative, banorët janë gjithmonë shumë të interesuar për ta takuar duke paraqitur kërkesa nga më të ndryshmet, flas nga përvoja ime 20 vjeçare punonjëse e institucionit të bashkisë dhe që të gjithë duan të takojnë atë. Kjo nuk do të thotë se janë njoftuar dhe është organizuar një takim. Nuk ka pasur asnjë takim të organizuar, flasim për rastin në fjalë nga ana e kryetares së Bashkisë zonjës Erisleda Sefa. Ajo gjithmonë.., sidomos Lumi Shkumbin edhe sot e kësaj dite vetë për të inspektuar sepse frika më e madhe është se çfarë mund të ndodhë dhe çfarë dotë bëjmë duke u gjendur në rrethanë edhe të financave të dobëta dhe gjithmonë në parashikim. Roli

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.06.2022*

jonë është gjithmonë në parashikim, në parandalim për të qenë sa më afër qytetarëve, asgjë më tepër.

Z. I. Celibashi: Faleminderit.

Znj. T. Kurti: Edhe një replikë të shkurtër, nëse do ishte kaq emergjente nuk e kuptoj pse nuk është përdorur procedura e hapur për tenderimin, por u desh një kohë shumë e gjatë dhe tenderimi do të vinte fiks dy muaj përpara fushtës.


Znj. D. Hida: Unë fola për tenderimin në tërësi, le ta themi jo për rastin konkret. Në ligjin e prokurimit, si ndodhin prokurimet për rastin konkret thashë nuk e di, sepse është një prokurim i organizuar nga një institucion tjetër. Po, duke pasur përvojë thashë kam një ide që ato zgjasin, asnjëherë nuk shkojnë në afatet e parashikuara.

Znj. T. Kurti: Edhe për më tepër nisja e këtyre punimeve ishte një periudhë shumë të vështirë si Janari që është një periudhë me shira.

Znj. D. Hida: Do të thoja vetëm një rast konkret. Ne jemi institucion që prokuron edhe fonde për shkollat. Na ka rastisur në momentin që na vihet në dispozicion fondi derisa lidhet kontrata, të bëhet tenderi i shkollës në momentin që fillon shkolla është kaq e vështirë, që të lutemi ne me shkresa. Ju lutem, shqyrtoni pak ankesat tona se nuk na pret puna, nxënësit duhet të detyrohen të strehohen në një shkollë tjetër. Disa gjëra që dalin përtej kapaciteteve tona, mundësive dhe dëshirës tonë.

Z. I. Celibashi: Qartë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.06.2022*

Znj. T. Kurti: Ajo që duhet, përtej kapaciteteve tuaja është tregimi i kujdesit siç parashikon vendimi nr. 9 i Komisionit Rregullator, që në periudha zgjedhore institucionet duhet të tregojnë kujdes të shtuar në daljet publike..

Znj. D. Hida: Të siguroj që kandidatja dhe kryetarja aktuale e bashkisë është një nga njerëzit më korrektë dhe më të kujdesshëm që unë njoh.

Znj. T. Kurti: Jo unë këtë siguri mund ta marr vetëm nga provat dhe faktet. Në këtë proces nuk keni paraqitur prova dhe fakte që e provojnë.

Znj. D. Hida: Të kryesh detyrën tënde në shërbim të qytetarëve të tu, 365 ditë në vit, nuk e kuptoj.

Z. J. Harka: Ne duam të shmangim në fakt të gjithë retorikën emocionale. Ne prezumojmë që mund të jenë vërtetë, problem është që ne kemi vërejtur një kontekst të një shkeljeje të ligjit dhe ne jemi këtu për të adresuar kontekstin në të cilën ju duhet të kujdeseshit të mos shkelnit ligjin. Për aq kohë sa ne e kemi konstatuar, jemi këtu për të marrë një vendim për këtë çështje.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit. E përfundojmë këtu. Atëherë, kemi ndonjë dokumentacion shtesë, ndonjë kërkesë shtesë të cilën ju e kërkonit të administrohet, ose juve si palë ?!

Z. J. Harka: Nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile janë paraqitur të gjithë dokumentacionet që shpresojmë të vërtetojnë procesin e investimit ...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.06.2022*

Z. I. Celibashi: Nuk kemi kërkesë për shtesë?!

Z. J. Harka: Por, për pjesën e aktivitetit publik, agjencia nuk e ka pasqyruar në asnjë lloj platforme.

Z. I. Celibashi: E kemi të qartë!

Z. J. Harka: Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Edhe për ju!

Znj. D. Hida: Nuk kemi kërkesë për shtesë, takimi nuk ka qenë i organizuar!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë, i japim fund hetimit administrativ. Fjala e fundit për përfaqësuesit e Qëndresës dhe fjala e fundit pastaj për palët e tjera në lidhje me shqyrtimin administrativ në fjalë.

Znj. T. Kurti: Në referim të të gjithë hetimit dhe përsa kemi paraqitur në prapësimet tona, ne përfundimisht kërkojmë konstatimin e shkeljeve nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe marrjen e sanksioneve administrative bazuar në nenin 172 dhe nenin 10 të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator ndaj Drejtorit të Autoritetit Kombëtar të Mbrojtjes Civile dhe ndaj subjektit Partia Socialiste dhe kandidates zonja Eriselda Sefa.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesja e kandidatit, fjala e fundit për ju, përfundimisht çfarë kërkonti?!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 28.06.2022*


Znj. D. Hida: Ne kërkojmë rrëzimet e pretendimeve që ngre Organizata Qëndresa Qytetare, duke pretenduar që nuk ka asnjë shkelje nga ana e kandidatës për kryetare të Bashkisë Lushnje, në rastin konkret.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po, përfaqësuesi i Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Z. J. Harka: Kërkojmë rrëzimin e pretendimit të ngritur nga Organizata Qëndresa Qytetare, për arsye se Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile nuk ka realizuar një aktivitet publik. Së dyti, investimi në atë infrastrukturë parandaluese, fatkeqësisht nuk ka qenë i planifikuar për efekt të fushatës zgjedhore, pasi teknikisht është e pamundur, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit juve. Mirë atëherë e përfundojmë shqyrtimin administrativ, shpalljen e vendimit ditën e enjte në orën 11:00, këtë të enjte.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

shkaqe të themi është kërkuar që të rihapet hetimi administrativ, pasi palët e interesuara në këtë shqyrtim, subjekti i interesuar në këtë shqyrtim ka marrë dijeni me vonesë dhe nuk ka pasur mundësi që të paraqesin pretendimet e tyre. Përfaqësuesit e Qëndresës, dakord me këtë?!

Mirë, atëherë palët prezentë, tjetër? Po, përfaqësuesi i Agjencisë, nga kandidati për Kryetar Bashkie?!


Znj. M. Angoni: Po, jam edhe vetë, kam edhe avokatin!

Z. M. Legisi: Avokat Maringlen Legisi, I nderuar! Përfaqësuesi i kandidatit për Kryetar Bashkie zonjës Majlinda Angoni. Është dhe vetë prezente kandidatja.

Z. I. Celibashi: Atëherë, ju japim fjalën përfaqësuesit të Agjencisë, pastaj kandidates, ose përfaqësuesit të kandidates, në lidhje me sa është pretenduar nga Organizata Qëndresa Qytetare për veprimtarinë tuaj në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme të datës 6 Mars 2022.

Z. J. Harka: Lidhur me adresimin e Qëndresës Qytetare ndaj autoritetit publik, Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile dhe Drejtorit të Përgjithshëm të saj mbi vizitën në familjen Gocaj të fshatit Obot, në Bashkinë e Shkodrës, ne i qëndrojmë sërish argumentimit tonë të paraqitur edhe në formë shkresore më përpara. Gjithashtu, ritheksoj sërish se nuk përbën vizita e Drejtorit të Përgjithshëm një aktivitet zyrtar të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Së pari, nuk ka qenë e planifikuar si aktivitet për komunikim me publikun për realizimin e një promovimi në interes të institucionit, apo për informimin e gjerë të qytetarëve. Qëllimi i kësaj vizite është i njejtë si gjithë vizitat e tjera që kryen Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

Civile, në rastin e familjeve të prekura nga fatkeqësitë. Në rastin konkret, familja është prekur nga fatkeqësia e zjarrit. Marr shkas nga shqetësimet e vazhdueshme, Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile është angazhuar për këtë vizitë për të verifikuar koordinimin e institucioneve qendrore dhe vendore për realizimin e pjesës pas fatkeqësisë për krijimin e kushteve minimale të jetesës së kësaj familje, që është edhe një detyrim ligjor. Ky ka qenë qëllimi i vizitës së Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile. Nga ana e agjencisë kjo vizitë nuk është promovuar në rrjete sociale apo instrumente të tjera të komunikimit me publikun, pasi për ne është një aktivitet rutinë për përmbushjen e aktivitetit koordinues dhe monitorues të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, mbi marrjen e masave nga institucionet qendrore dhe vendore, siç ishte rezerva e materialeve të shtetit, për sigurimin me materiale bazë të jetesës së kësaj familje, apo veprimtari e institucioneve vendore për të siguruar një strehim të përkohshëm të kësaj familje. Pretendimi se është premtuar rindërtimi i kësaj shtëpie nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile është e pamundur teknikisht, pasi rindërtimi nuk është kompetencë e Agjencisë dhe ne nuk kemi premtuar gjëra të kësaj natyre. Nuk ka qenë qëllimi premtimi për këtë familje, por thjesht verifikimi për kushtet e jetesës së kësaj familje. A janë plotësuar standardet minimale, në përputhje me Ligjin për “Mbrojtjen Civile”? Ky ishte qëllimi i vizitës dhe jo për çështje politike apo të ndonjë subjekti tjetër zgjedhor. Për më tepër, nuk është se janë përdorur burime financiare, logjistike apo simbolika për çështje politike. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit juve. Kandidatja, zonja Angoni, apo përfaqësuesi i kandidatës?! Ju vendosni.

Z. M. Legisi: Përsa i përket rastit ne kërkojmë të sqarojmë fillimisht dhe t'i bëjmë me dije Komisionerit që prania e zonjës Angoni aty nuk ka qenë thjesht si një

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

kandidate potenciale për kryetare bashkie. Ajo është paraqitur aty fillimisht si një ishprefekte apo si një banore e Shkodrës, sepse ka pasur njohje të mëparshme me banorët e zonës sepse fillimisht ka qenë prefekte dhe më pas ka dhënë dorëheqjen. Nuk është se ka qenë një prezencë e saj aty, thjesht sa për të bërë një intervistë tek një kanal lokal që mezi apo nuk njihet. Prezenca aty ka qenë për shkak të fatkeqësisë natyrore që ka gjetur familjen Gocaj. I nderuar, edhe takimi me zotin Çako, si Drejtor i agjencisë nuk ka qenë aspak i organizuar dhe aspak i koordinuar. Nëse do të kishte qenë i tillë kjo do të rezultonte prapë edhe nga provat e tjera, le të themi tek postimi i faqes në facebook është sjellë si provë, por aty nuk është vendosur aspak, as në ato data apo një datë të mëvonshme nga zonja Angoni. Nuk ka qenë aspak e organizuar, por ka qenë tërësisht ratësor. Zoti Kryetar edhe në mbështetje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor sqaron se, “nuk mund të përdoren apo të vihen në mbështetje të kandidatëve, partive politike ose koalicioneve në zgjedhje, burime të organeve publike në nivel qendror ose vendor”. Ka edhe burime njerëzore, ku kuptohet me burim njerëzor, përdorim i detyruar. Jemi përpara rastit ku këtu edhe intervista, apo foto e intervistës është dhënë përpara. Tani, nëse mund ta japë një sqarim Qëndresa Qytetare që zonja Angoni ka përdorur në mënyrë të detyruar drejtuesin e këtij institucioni? Sepse nuk ka ndodhur asnjë rast i tillë. Ne nuk kemi përdorur në asnjë moment në mënyrë të detyruar asnjë rast. Edhe takimi ka qenë shumë i rastësishëm.

Zj. M. Angoni: Përshëndetje, siç e theksoi edhe avokati, unë për arsye të pozicionit që kam pasur në zonën e Obotit kam qenë pothuajse tre muajt e vitit dhe çdo banor i fshatit aty ka numrin tim të telefonit. Të vjen ndjeshmëria, nuk ka lidhje të jesh apo mos jesh kandidate, në momentin që jeton në atë zonë të vjen edhe një ndjeshmëri civile. Në momentin që të bie zilja e telefonit je e detyruar për të shkuar dhe për ta parë dhe krejtësisht në mënyrë të rastësishme jam takuar me zotin Çako, sepse edhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

prefektura kishte bërë njoftimin, një rutinë e zakonshme që përdoret për t'ju gjendur njerëzve në nevojë. Aty në raste të tilla ndodhen aksidentalisht, jo aksidentalisht por shkojnë edhe televizionet lokale, koicidenca ishim edhe ne aty. Nuk u bë asnjë premtim, sepse nëse do të dëgjonit edhe ligjërimin e kryetarit të agjencisë është e thënë sepse është detyrë e bashkisë marrja e të gjitha masave. Prezenca jonë aty ishte për ta nxitur, sepse në praktikën tonë ka pasur shumë zvarritje vetëm, sepse nuk janë marrë masat, si të thuash ekzaminimi i dëmeve të menjëhershme ose procedurat kohore dhe shumë herë ndihma ka vonuar për t'i shkuar, procedura që unë vetë i kam hasur gjatë punës sime si prefekte me kryetaren e bashkisë. Pra, janë disa koicidenca që unë as nuk e kam vënë në faqen zyrtare. Kemi shkuar, të kap ai vrulli, emocioni për t'iu gjendur njerëzve në nevojë dhe aq. Për dijeninë tuaj ajo zonë është aq e djathtë sa nuk më ka shkuar mendja, edhe të zotët e shtëpisë nuk kanë votuar për mua, kështuqë pak para 10 minutash kishte qenë edhe kandidati tjetër. Faleminderit.

Z. M. Legisi: Përfundimisht I nderuar, përsa na takon që ta mbyllim, ne vlerësojmë se në bazë të nenit 82 të Kodit të Procedurës Administrative dhe në vlerësim të pikës 1 dhe 2 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, vlerësojmë se barra e provës i bie palës që ka inicuar procedurat administrative dhe vetëm thjesht një foto aty apo një intervistë tepër formale nuk provon shkeljen e asnjë prej pikave të pretenduara.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e organizatës, pyetje apo replikë në lidhje me këtë? Prapësime?

Znj. T. Kurti: Dua ta nis nga përfaqësuesi e Agjencisë së Mbrojtjes Civile, i cili duhet të jetë më i përgjegjshëm kur bën deklarime pasi nuk mund të thoni që nuk është publikuar apo nuk ka pasur dalje duke qenë se ne kemi provë një transmetimin

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

televiziv në një media lokale. Prezenca e medias i jep karakter publik këtij aktiviteti, e bën këtë një aktivitet të ndaluar për t'u promovuar. Po ashtu pala tjetër e rëndon pozitën e saj duke pranuar dorëheqjen dhe thotë që ndodhej aty për arsye njohje. Institucioni, duke qenë se ju kishit dhënë dorëheqjen, kush ju njoftoi?

Znj. M. Angoni: Familja.


Z. I. Celibashi: Prit një sekondë, të lutem.

Znj. T. Kurti: Kush ju njoftoi që të gjendeshit aty? Për më tepër përse i përket ligjëratës drejtori i AKMC-së shprehet e thënë me gojën e tij se do të ofrohen ndihma ushqimore për familjen dhe do të fillojë dhe ndërtimi i shtëpisë nga fondi i AKMC-së, gjë që pranohet edhe nga shkresat e ardhura nga AKMC-ja.

Z. I. Celibashi: Kishit diçka tjetër për të shtuar?

Z. M. Qiraxhi: Faleminderit zoti Celibashi. Sigurisht që ne kemi vendosur përpara jush edhe materialet video të cilat deri diku tregojnë që një aktivitet i cili bën titullarët bashkë edhe median bashkë nuk mund të jetë aty rastësisht në një cep të Shqipërisë. Sigurisht nuk do të kishte një vëmendje të shtuar nëse nuk do të ndodhej një kontekst i zgjedhur i cili në fakt ndodhet aty në shkelje të ligjit. Sigurisht ne do të duam edhe njëherë, i bëj thirrje palëve të tjera që të jemi sa më pak emocional edhe t'i referohemi ligjit. Ne nuk jemi këtu për të diskutuar angazhimin e tyre qytetar apo dëshirat e tyre për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve por kjo duhet të bëhet brenda një kuadri ligjor edhe për më tepër nuk duhet të zgjerojmë fjalorin për të thënë se votoi familja apo nuk votoi. Vota është e fshehtë dhe askush nuk mund ta

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*


dijë. Ne nuk duhet të futemi në këtë situatë dhe ne kemi shqyrtuar thjesht edhe vetëm a jemi brenda një kriteri të cilën e ndalon ligji. Brenda një takimi ku ndohet zoti Haki Çako i emergjencave civile, kandidatja për Bashkinë e Shkodrës nga Partia Socialiste, gjithashtu dhe një mediat e cila nuk është pak e dëgjuar, sigurisht është një nga mediat kryesore lokale në Bashkinë e Shkodrës, është e licensuar dhe kryen veprimtarinë e saj si një media e rregullt e cila në fakt nuk mund të shëtisë me kamerë kuturu në atë territor. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po!

Z. M. Legisi: Faleminderit, I nderuar! Ne pikërisht ligjit ju referuam. Këto janë faje që duhet të provohen. Pra, ne e pretenduam dhe e sqaruam Komisionerin që ka qenë thjesht rastësor dhe aspak i organizuar. Tani si e provojmë faktin, sepse neni 92 kërkon thotë “në përdorim të detyruar të burimeve njerëzore”. Kuptohet përdorim i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve, por nuk jemi në këtë rast. Neni 84 i Kodit të Procedurës Administrative i ngarkon me barrë palën inciuese të procedimit administrativ. Tani si e vlerësojnë këta, si e provojnë këta, ka patur përdorim të detyruar? Sepse nga ana e tyre nuk ka asnjë hetim se kush e ka thirrur median aty. Meqenëse i referohemi ligjit gjithmonë sepse ky ishte dhe pretendimi ynë, po t’i referohemi ligjit.

Znj. M. Angoni: Zona e Obotit është një zonë afër Shkodrës dhe ka një ndjeshmëri dhe media lokale pret që të ketë raste të tilla. Nuk është rast i vogël për t’u djeg shtëpia dhe të rrezikojnë jetën dy banorë. Nuk është se media është thirrur madje mua më erdhi inat që gjeta median aty, sepse nuk ishte rasti për të gjetur median. Aq

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

gjë e dija që nuk duhet të ishte. Për të me lajmëruar unë sapo ua thashë në fillim që numrin tim të telefonit e kanë gjithë banorët e asaj zone, sepse kanë qenë tre muaj të përmbytur dhe unë non stop tërë muajin kam qenë atje. U dogjën, muarën numrin e telefonit, nuk e dinin a kam dhënë dorëheqjen a s'kam dhënë dorëheqjen dhe kështu që të përfshijnë. Unë u tregova e sinqertë në ligjërimin tim për të treguar edhe anën emocionale, sepse nuk mund të jemi fare ligjërisht të ndarë edhe pse respektojmë ligjin, por nga ana tjetër vlerësojmë që jeta e njerëzve edhe ndihma që duhet të jepet në ato raste të zhvesh nga çdo skaletë që mundesh me pas, faleminderit.


Z. I. Celibashi: Faleminderit. Kemi ndonjë kërkesë për marrjen e provave shtesë nga përfaqësuesi i Qëndresës?

Znj. T. Kurti: Prova shtesë nuk kemi për aq kohë sa zonja Angoni thotë se çdo banor e ka numrin tim dhe jemi njoftuar me telefon. Për më tepër barra e provës nuk i bie denoncuesit, ndaj niset nje process hetimor dhe kërkohet dhe informacion nga ana juaj. Ligjërata në daljen tuaj publike është e pastër dhe nuk ka nevojë as për interpretim. Është një provë e pastër që në referim të nenit 91 dhe nenit 6 pika 3 të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, drejtori i një agjencie shtetërore gjatë orarit zyrtar të punës shfaqet pranë një kandidateje në një periudhë zgjedhore në një veprimtari me karakter publik i cili jepet qartësisht transmetimi në television i kësaj daljeje.

Z. I. Celibashi: Dmth, prova të tjera nuk kërkohen?

Znj. T. Kurti: Jo!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

Z. I. Celibashi: Juve keni kërkesë për t'u administruar prova të tjera?

Z. M. Legisi: Jo ne nuk kemi prova të tjera.

Z. I. Celibashi: Ju, përfaqësuesi agjencisë?

Z. J. Harka: Jo! Besoj se pala tjetër duhet të paraqesë provën se kush e ka njoftuar..


Z. I. Celibashi: Atëherë i japim fund hetimit administrativ. I japim fjalën palëve për pretendimet e tyre të fundit. Po, përfaqësuesit e Qëndresës

Znj. T. Kurti: Për sa parashtruar kërkojmë nga ana juaj konstatimin e shkeljeve dhe marrjen e sanksioneve administrative bazuar në nenin 172 dhe nenin 10 të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator ndaj drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile zotit Haki Çako dhe ndaj subjektit zgjedhor Partia Socialiste dhe ndaj kandidates zonja Majlinda Angoni.

Z. I. Celibashi: Po përfaqësuesi i agjencisë përfundimisht?

Z. J. Harka: Ne kërkojmë rrëzimin e pretendimeve të organizatës për arsye se pretendimet e tyre nuk janë të provuara. Një aktivitet që nuk është kryer zyrtarisht nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe për më tepër komunimikimi ka qenë rastësor. Nëse një nga gazetarët të pyet në vendin e ngjarjes se çfarë do të bëjmë me këtë familje, detyrimisht që instituicioni duhet të tregojë rolin e tij dhe përgjegjshmërinë ligjore ndaj nevojave që ka ajo familje në rastin e fatkeqesisë natyrore që është sigurimi i kushteve të jetesës. Faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 28.06.2022*

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësuesi ose kandidatja?

Z. M. Legisi: Faleminderit I nderuar! Ne kërkojmë përfundimisht rrëzimin e kërkesës. Nuk ka takim të organizuar, nuk ka përdorim të burimeve të enteve publike në nivel qendror apo nivel vendor ku shteti zotëron kuota apo kapitale, apo emëron shumicën e organeve mbikqyrëse, apo organe drejtuese të entit. Nuk ka përdorim të detyruar, as të padetyruar të burimeve njerëzore sipas pikës 2 të nenit 9, të Kodit Zgjedhor, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Kandidatja zonja Angoni?

Znj. M. Angoni: Jo!

Z. I. Celibashi: Dakord! Atëherë e mbyllim shqyrtimin administrativ dhe shpallim vendimin ditën e enjte në të njëjtën orë për këtë çështje.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

